Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 20, datë 26.08.2020, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

Deklasifikimi i plotë i dosjeve:

1. Dosje personale nr. 62, në ngarkim të R.M., me 38 (tridhjetë e tetë) fletë. Pseudonimi “Revizori”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket Fondit të Veçantë, A. 32-85, D.3.
2. Dosje personale nr. 300, në ngarkim të S.D., me 22 (njëzetë e dy) fletë. Pseudonimi “Maja e Pojanit”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket fondit Operativ, K. 173.
3. Fashikull nr. 561, në ngarkim të E. K., 2 vëllime me 335 (treqind e tridhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.
4. Dosje personale nr. 3599, në ngarkim të Th.K., me 13 (trembëdhjetë) fletë. Pseudonimi “Bajamja e Hormovës”, kategoria “A”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket fondit Operativ, K. 182.
5. Dosje personale nr. 2626, në ngarkim të K.D., me 151 (njëqind e pesëdhjetë e një) fletë. Pseudonimi “Filantropi”, kategoria “A”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket fondit Operativ, K. 149.
6. Dosje personale nr. 537, në ngarkim të H.K., me 82 (tetëdhjetë e dy) fletë. Pseudonimi “Datë Fitimi”, kategoria “A”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket fondit Operativ, K. 149.
7. Dosje personale nr. 308, në ngarkim të V.B., me 97 (nëntëdhjetë e shtatë) fletë. Pseudonimi “Peza e Madhe”, kategoria “S”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket fondit Operativ, K. 183

1. Dosje personale nr. 7, në ngarkim të I.N., me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë. Pseudonimi “Pisha e Gjatë”, kategoria “A”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket fondit Operativ, K. 149.
2. Dosje personale nr. 580, në ngarkim të Sh.D., me 32 (tridhjetë e dy) fletë. Pseudonimi “Eshkani”, kategoria “I”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket fondit Operativ, K. 149.
3. Dosje personale nr. 80, në ngarkim të B.A., me 20 (njëzetë) fletë. Pseudonimi “Rrushi i Pjekur”, kategoria “A”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket fondit Operativ, K. 173.
4. Dosje personale dhe pune nr. 113, në ngarkim të I.M., me 14 (katërmbëdhjetë) fletë. Dosja e punës nuk ka raporte. Pseudonimi “Sahati i Kavajës”, kategoria “I”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket fondit Operativ, K. 171.
5. Dosje personale nr. 15, në ngarkim të Gj.P., me 39 (tridhjetë e nëntë) fletë. Dosja e Punës nuk ka raporte. Pseudonimi “Trimëria”, kategoria “I”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, K. 13, D.24.
6. Dosje personale nr. 320, në ngarkim të H.D., me 33 (tridhjetë e tre) fletë. Pseudonimi “Mëshini i Zi”, kategoria “A”. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Fondi Operativ, K. 179.
7. Fashikull ndjekje të lidhjeve të diversantëve të riatdhesuar nr. 23, në ngarkim të H.Sh., me 41 (dyzetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Pukë, A.10.
8. Dosje përpunimi me pseudonimin “Lepuri” nr. 32, në ngarkim të H.Sh., me 237 (dyqind e tridhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, A.8. D. 5.
9. Dosje formulare nr. 369, kategoria 2/A, në ngarkim të H.Sh., me 4 vëllime me 572 (pesëqind e shtatëdhjetë e dy) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket fondit Operativ, K. 82.
10. Dosje formulare nr. 369, kategoria 2/B, në ngarkim të P.Q., me 50 (pesëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tiranë, A.34. D.3.
11. Dosje formulare nr. 3415, në ngarkim të P.M., me 2 volume dhe fashikull me biseda telefonike dhe informata në gjuhën italiane me 490(katërqind e nëntëdhjetë) fletë + 37 fletë në zarf. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dosja i përket fondit Dega e Punëve të Brendshme Tiranë, A.20. D. 3
12. Kartelë model 4 nr. 3100, në ngarkim të M.C., 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “sekret”. Fondi i Zbulimit (Itali), sirtari nr. 14.
13. Kartelë model 2, nr. 535, në ngarkim të N.P., 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “tepër sekret”. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.
14. Kartelë model 2, nr. 662, në ngarkim të N.K., 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “tepër sekret”. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.

15. Kartelë model 2, nr. 3880, në ngarkim të N.I., 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “tepër sekret”. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër.
16. Dosja nr. 66, “Relacion dërguar shokut E. H. mbi disa ndryshime në organizimin e punës në drejtim të evidencës së kontingjenteve të elementit kundërshtar dhe udhëzim i ministrit dërguar organeve të sigurimit.”, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr.4, Drejtoria e I, Viti 1954, kutia 1, Shtabi.
17. Dosja nr. 64/1, “Direktiva e Ministrit të Punëve të Brendshme nr.01-102 datë 18.11.1953 “Mbi përmisimin e punës me agjunkturën dhe me përpunimet” dhe një shënim i i Ministrit të Punëve të Brendshme, datë 29.10.1982.”, me 22 (njëzetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit “tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr.4, Drejtoria e I, Viti 1953, kutia 1, Shtabi.
18. Dosja nr. 61, “Direktivë orientuese e Ministrit të Punëve të Brendshme dërguar sektorit të V-të të kundërzbulimit dhe goditjes e agjentëve të zbulimeve kapitalisto-revizioniste dhe detyrat e organeve të sigurimit të shtetit gjatë vitit 1953”, me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit “tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr.4, Drejtoria e I, Viti 1953, kutia 1, Shtabi.
19. Dosja nr. 68, “Udhëzim i zëvendësministrit mbi ngritjen dhe organizimin e agjunkturës kërkuese për zbulimin dhe kapjen e agjentëve të huaj që futen në vendin tonë si diversant etj”, me 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit “tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr.4, Drejtoria e I, Viti 1954, kutia 2, Shtabi.
20. Dosja nr. 60, “Direktiva e Ministrit të Punëve të Brendshme mbi përmisimin e punës me agjunkturën dhe përpunimet e organeve të sigurimit të shtetit” dhe “Qarkore mbi të metat rreth zbatimit të direktivës së ministrit”, me 26 (njëzetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit “tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr.4, Drejtoria e I, Viti 1953, kutia 1, Shtabi.
21. Dosja nr. 129, “Udhëzim dërguar Degëve të Punëve të Brendshme mbi mënyrën e mbajtjes të evidencave për kontingjentet e spiunazheve të huaja dhe për të arratisurit”, me 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit “tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr.4, Drejtoria e I, Viti 1953.
22. Dosja nr. 35, “Instruksion mbi organizimin e punës agjenturiale operative në kampe e burgje”, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “tepër sekret”. Dosja i përket Fondit nr.4, Drejtoria e I, Viti 1955.
23. Fondi nr.4, Bandat, Viti 1951, Kutia 40, Dosja nr. 75, “Relacione mbi likuidimin e diversantëve të ardhur dhe të brendshëm dhe mbi gjendjen e bandave të diversantëve të dërguar nga zbulimet kapitalisto-revizioniste”, me 8(tetë) fletë. Niveli i klasifikimit “tepër sekret”.
24. Fondi nr.4, Bandat, Viti 1954, Kutia 41, Dosja nr. 93, “Relacione mbi veprimtarinë e bandave të armatosura dhe diversantëve të ardhur nga zbulimet e huaja gjatë vitit 1954”, me 34(tridhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit “tepër sekret”.
25. Fondi nr.4, Kundërzbulimi i kufirit, Viti 1954, Kutia 35, Dosja nr. 10, “Instruksion mbi punën agjenturiale-operative të organeve të zbulimit të kufirit”, me 34(tridhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit “tepër sekret”.

26. Fondi nr.4, Shtabi, Viti 1956, Kutia 2, Dosja nr. 91, “Udhëzim mbi lëvizjen e dosjeve agjentoriale nga një sektor në tjetrin”, me 34(tridhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit “sekret”.
27. Fondi nr.4, Drejtoria II-të, Viti 1955, Kutia 12, Dosja nr. 153, “Udhëzim mbi krijimin e dosjeve të objektit për kontingjentet kryesore”, me 3(tre) fletë. Niveli i klasifikimit “tepër sekret”.
28. Fondi nr.4, Dega IV, Viti 1955, Kutia 46, Dosja nr. 46, “Instruksion mbi arshivën operative të organeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme aprovuar nga ministri”, me 37(tridhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit “për sekret”.
29. Fondi nr.4, Dega V, Viti 1950, Kutia 49, Dosja nr. 14, “Propozim i Ministrit të Brendshëm dërguar Byrosë Politike të PPSH-së mbi disa shtesa për platformën e organeve sigurimit dhe aprovim nga Komiteti Qendror”, me 3 (tre) fletë. Niveli i klasifikimit “sekret”

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

**VEPRIMTARI TË
AUTORITETIT PËR
INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E
ISH-SIGURIMIT TË
SHTETIT PËR
PERIUDHËN
KORRIK - GUSHT**

VEPRIMTARI TË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT PËR PERIUdhËN KORRIK - GUSHT

*Për qëllim të edukimit qytetar, në bazë të Kalendarit të kujtesës dhe në kuadër të informimit, ndërgjegjësimit të shoqërisë, DMSHEQ ka organizuar një sërë aktivitete, të miratuara më herët në Autoritet, duke iu përshtatur kushteve të krijuara nga pandemia Covid 2019, për të cilët është koordinuar infrastruktura përkatëse, janë përgatitur ftesa, programe, shpërndarje dhe informacione e njoftime për shtyp, për komunikim të zgjeruar me partnerët dhe publikun e interesuar.


➤ **Botimi i përmbledhjeve dhe kumtesave si produkt i konferencës ndërkombëtare shkencore: “Të mohuar nga regjimi, burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri, 1945-1990”**

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Instituti i Historisë në Akademinë e Studimeve Albanologjike, me mbështetjen e Fondacionit Konrad Adenauer në Tiranë, bashkëpunuan për finalizimin e botimit “Të mohuar nga regjimi, burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri, 1945-1990”. Ky botim, është produkt i konferencës ndërkombëtare shkencore me të njëjtën tematikë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve homologe europiane të kujtesës, e organizuar në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar, në kuadër të programit “Përkujtojmë për të shëruar e parandaluar”, mbështetur nga PNUD Shqipëri dhe Qeveria e Italisë.

Botimi “Të mohuar nga regjimi” përmban 36 artikuj të thelluar studimorë mbi sistemin e burgjeve, internim-dëbimeve dhe punës së detyruar në Shqipëri, gjatë viteve 1945-1990 dhe do të pasohet nga përmbledhjet e punimeve të konferencave që AIDSSH ka zhvilluar në bashkëpunim me partnerë akademikë dhe të kujtesës, me hulumtimet që mbështesin dialogun konstruktiv dhe ndihmojnë shoqërinë shqiptare të trajtojë trashëgiminë e tëshkuarës komuniste.

AIDSSH deklasifikoi një numër voluminoz dosjesh që u vunë në dispozicion të studiuesve dhe të interesuarve. Ndërkohë këtë vit, AIDSSH zhvilloi konferencën mbi emigracionin politik shqiptar, 1944-1990, që hapi siparin e hulumtimeve dhe studimeve shkencore për shqiptarët e përndjekur brenda dhe jashtë vendit.

Libri mund të lexohet në versionin online në faqen issue te AIDSSH, në linkun [AIDSSH - Issuu](#)



➤ **Prezantimi i dokumentarit: “Persekutimi i “kulakëve” në diktaturë, Shaban Plaka”**


Më 21 korrik 2020 në fshatin Gostimë të Bashkisë Cërrik, u prezantua dokumentari i gazetares Luljeta Progni: “Persekutimi i “kulakëve” në diktaturë, Shaban Plaka” i realizuar mbi dëshmitë e familjarëve dhe materialet arkivore të tërhequra prej tyre pranë AIDSSH-së për familjen Plaka, vëllezërit Shaban dhe Ibrahim Plaka.

Përfaqësues të AIDSSH, komunitetit të të përndjekurve të zonës dhe shoqatave të të drejtave të njeriut, familjarë dhe bashkëfshatarë e përkujtuan figurën e Shaban Plakës, në fshatin e tij, Gostimë, ku familja ka pasur kontribute të njohura.

Familja Plaka u persekutua në shkallë të gjerë, u izolua, iu mohua e drejta për t’u arsimuar dhe ecur përpara, marrë pjesë në aktivitete, grumbullime sociale, kulturore, etj., u trajtua si “armike e popullit”, duke u demaskuar edhe publikisht.

Në nderim të 11 burrave të fisit të njohur Plaka, të dënuar politikisht nga regjimi komunist me pushkatim, burgim, punë të detyruar dhe internim, sot në Gostimë ka një rrugë me emrin “Shaban Plaka”.

Dokumente dhe materiale arkivore të AIDSSH janë vënë në dispozicion të qytetarëve, familjarëve të të dënuarve politikë, studiuesve dhe gazetarëve, sipas kërkesës. Hulumtimi në materiale arkivore ka prodhuar artikuj shkencorë, mediatikë, filma dhe dokumentarë, speciale dhe ekskluzive, si bashkëpunime të AIDSSH me institucione partnere, organizata apo individë, për të rritur ndërgjegjësimin për krimet e komunizmit, për të inkurajuar dialog me universitetet, akademikët, komunitetet vendore, të mbijetuarit e familjarët e tyre, mediat dhe publikun e gjerë.



➤ **Firmoset Marrëveshja e Bashkëpunimit me Komisionin Ndërkombëtar të Personave të Zhdukur**

Më 24 korrik, Kryetarja e AIDSSH, znj. Gentiana Sula, firmosi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Komisionin Ndërkombëtar të Personave të Zhdukur, në kuadër të zbatimit të projektit të përbashkët, financuar nga BE, për rritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve dhe familjarëve për çështjen e të zhdukurve gjatë komunizmit.

Projekti i përbashkët ICMP-AIDSSH synon të hartojë dhe publikojë një udhëzues mbi të drejtat dhe detyrimet e legjislacionit shqiptar e ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut, sa u takon personave të zhdukur në diktaturë për shkaqe politike dhe shkelje të të drejtave të njeriut. Udhëzuesi do të mbështetet me takime informuese, mbledhje të dëshmive dhe punë kërkimore në arkiva, për qartësimin e fatit të tyre.

Po ashtu, një ekspozitë e profileve të të zhdukurve, dialogë lokalë ndërgjegjësues dhe botime të punës hulumtuese e dëshmive gojore dhe mbështetje e shoqatave e familjarëve të të zhdukurve në diktaturë.



➤ **Dita Europiane në Përkujtim të Viktimave të Totalitarizmit në ish-kampin e internimit në Tepelenë**

Më 23 gusht, në Ditën Europiane në Përkujtim të Viktimave të Totalitarizmit, AIDSSH mori pjesë në pelegrinazhin e dhimbjes në kampin e Tepelenës, me ata që i mbijetuan dhe trashëgimtarët e tyre, me qëllim nderimin e të mbijetuarve dhe sakrificave, njohjen dhe vlerësimin përmes kujtimeve, të dramës njerëzore të mijëra familjeve, të jetuar ditë pas dite.


Përkujtimi është vijimësi e punës së Autoritetit, mbështetur në parimet e rëndësishme të kujtesës, që e vënë memorien historike në themel të identitetit dhe trashëgimisë së individëve e bashkësive, si paraqitja e këndvështrimeve të ndryshme; evitimi i shprehjeve deterministe: shmangia e përgjithësimeve; trajtimi i figurave historike si individë; sigurimi i një baze gjenuine historike; përdorimi i njohurive të nivelit akademik si burime, ku çdo përmbajtje duhet të ballafaqohet e të diskutohet me akademikë të njohur dhe certifikuar për njohuritë specifike e të duhura për këtë punë.

Ndërkohë, projektideja e Memorialit në kampin e dëbim-internimit të Tepelenës është ende në zhvillim. Autoriteti është i hapur për bashkëpunim me të gjithë aktorët e faktorët, në mënyrë që Kampi i Tepelenës, si dëshmi e kampeve të punës së detyruar në diktaturë, të përfaqësojë një vend reflektimi për të rinjtë, studentët, qytetarët dhe të nderojë sakrificën e dinjitetin njerëzor të mijëra vetave, burra, gra e fëmijë, që u keqtrajtuuan në kampet e punës së detyruar në të gjithë vendin.



➤ Tryeza e rrumbullakët “95 vjet Martin Camaj – Vepra dhe përndjekja”

“Në fjalë sqarohet qiell e dhé bashkë” - Martin Camaj



Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Akademinë e Studimeve Albanologjike, Institutin e Historisë, Shtëpinë botuese “Onufri”, Shoqatën “Martin Camaj” në Gjermani, Teatrin “Migjeni” Shkodër dhe Autoritetin Gjerman të Hapjes së Dosjeve (BSTU Gjermani), në kontakt me familjarë e bashkëpunëtorë të Camajt dhe studiues të tij, organizoi më 28 gusht tryezën e rrumbullakët “95 vjet Martin Camaj, vepra dhe përndjekja”, takim i hapur për mediat.

Të pranishëm në tryezë, me zërin dhe qëndrimet e veta ishin familja, bashkëpunëtorët e afërt, pasuesit e punës së tij si albanolog, studiues të jetës, historianë, dhe të krijimtarisë së tij, akademike, letrare, gjuhësore, artistike, studiues që kanë tërhequr dosjen e tij ose janë shprehur në lidhje me të. Kryeministri i vendit, z. Edi Rama, mori pjesë në tryezë dhe mbajti fjalën e rastit.

Jeta, vepra dhe përndjekja e albanologut Martin Camaj u prezantuan në një material audioviziv të përgatitur nga AIDSSH, duke cekur të gjitha çështjet me radhë.

Znj. Gentiana Sula, Kryetare e AIDSSH, e hapi takimin me disa pyetje për raportin e Camajt me regjimin e kohës e më gjerë: A krijoi dhe shpërndau Sigurimi i Shtetit mjete damkosëse – apo “fake neës” - që të defaktorizonin Camajn nga viti 1945 deri në 1990? A ka ende sot e kësaj dite stereotipe që thjesht aktivizohen në mënyrë auto-pilote në nënvetëdijen tonë kolektive, plot klishe nga propaganda 50-vjeçare? Cila është kostoja e mungesës së gjatë të Camajt në formimin tonë individual apo kolektiv? Në përgjigje të tyre, kryetarja Sula paraqiti qëndrimin e vet “mbi tre mitet që hasen sot, me gjasë krijuar e prodhuar nga vetë Sigurimi. Miti i parë ka lidhje me besimin e verbër se Sigurimi ishte një organizatë e sofistikuar spiunazhi. Miti i dytë lidhet me faktin se Sigurimi i mbrojti mirë interesat kombëtare, prandaj zbardhja e dokumenteve e cenon sigurinë kombëtare. Miti i tretë lidhet me besimin e verbër se dokumenti i Sigurimit flet vetë. Me këtë rast dëshiroj të ndaj me ju një metodë të Sigurimit që më ka shqetësuar prej kohësh: demaskimin. Ne kemi hasur shumë dokumente dhe statistika të demaskimit në bashkësi të njerëzve të nderuar. Në fakt fabrikoheshin fake news për të mbërritur vrasjen morale afatgjatë të

figurave me ndikim. Unë do ta quaja damkosje, duke përfytyruar një gjë që djeg në mish... por meqenëse kjo ka efekt edhe pas vdekjes – mund të quhet edhe stereotip, apo klishe, apo hije e gjatë... Për një hulumtim realist, ka shumë rëndësi të kuptohet që dokumentet e shërbimeve në përgjithësi, janë perfide, mashtruese, fake news.

Këto damkosje apo stereotipe janë le të themi, si një virus. Virusi hyn në mendjet e reja dhe synon të riprodhojë vetveten, për ta çorientuar atë. Ashtu edhe këto klishe mund të çorientojnë brezat drejt një miopie të mykur, përcarëse e të ndrydhur. Virusi nuk zhduket vetë, po të mos prodhojmë DIJEN si kurim apo vaksinë, për të çmontuar këto mekanizma të mbrapshtë. Për të zhvilluar imunitetin e nevojshëm, që të mos biem viktima të saj përsëri e përsëri. Për të reflektuar duke zgjeruar horizontin në përmasat që jep liria... Le të hapim mendjen dhe zemrën për të hequr dorë nga klisjet që ndajnë shqiptarët e që na mbajnë larg veprës së personaliteteve që nuk u bënë keq shqiptarëve.”

Kryeministri i vendit, z. Edi Rama e mori fjalën për të shprehur “kënaqësinë e shumëfishtë, natyrisht si Kryeministër, por do të isha këtu edhe po të mos isha Kryeministër, sepse Martin Camajn e kam njohur, fatkeqësisht jo sy për sy, por kemi pasur kontakt të vazhdueshëm sëbashku. Jemi njohur me zë dhe kam pasur nderin ta përcjell në banesën e fundit, në atë ditë kur u nda nga të gjithë ata që e shoqëruan në dëborë.

Natyrisht që si Kryeministër vij me kënaqësi për t’i shprehur konsideratën time Autoritetit të Dosjeve për punën aspak të lehtë, por gjithashtu të madhe që ka bërë dhe për ta inkurajuar që jo vetëm të vazhdojë punën e bërë deri më sot, por edhe të dalë më shumë nga suaza e vet, për t’i përcjellë më shumë publikut shqiptar fjalë si ato që tha me shumë ndjeshmëri dhe njëkohësisht kompetencë mbresëlënëse drejtuesja.

Është për mua kënaqësi, por edhe nder që të marr pjesë në një tjetër “varrim” sot, këtu, në varrimin e shpifjeve dhe të akuzave që Martin Camaj mori jo më nga ata që i privuan atdheun, por nga ata që nuk e lanë as në botën tjetër të qetë. Për këtë arsye besoj që kjo që bëhet sot është përtej thjesht detyrës së Autoritetit të Dosjeve, është një akt human dhe një detyrim i kryer ndaj jo thjesht Martin Camajt, por ndaj vetes, ndaj shoqërisë, ndaj vendit.”





Dr. Erika Camaj, bashkëshorte e Prof. Martin Camajt dhe kryetare e nderit të Shoqatës “Martin Camaj” mori pjesë në tryezë me fjalën përshëndetëse, të lexuar nga Zuzana Finger, përkthyes dhe kryetare e Shoqatës “Martin Camaj” në Gjermani. “Të nderuar organizatorë të tryezës së rrumbullakët „95 vjet Martin Camaj – vepra dhe përndjekja”. Për shkaqe familjare nuk mund të jem sot personalisht mes jush, por doja t’ju shprehja mirënjohjen për kontributet tuaja në reflektimin e veprës dhe jetës së Martin Camajt, në kuadër të historisë së kulturës shqiptare. Qëllimi i Shoqatë sonë është përkrahja e hulumtimit të trashëgimisë letrare të Martin Camajt dhe të shkëmbimit kulturor gjermano-shqiptar. Shpresoj që nëpërmjet kësaj konference mund të themelojmë një bashkëpunim të ri e të frytshëm. Ju uroj shumë suksese ne anganzhimin tuaj shkencor dhe kulturor”.

Prof. Dr. Bardhyl Demiraj, drejtues i katedrës së Albanologjisë në Universitetin Ludwig Maximilian, Mynih, bashkorganizator i aktivitetit dhe i pari studiues që bëri kërkesë pranë AIDSSH për dosjen e Camajt, paraqiti temën “Mbi veprimtarinë e Camajt në Mynih, korrespondenca me Koliqin”, me shumë elementë të dhënë për herë të parë për të interesuarit.

Sesioni Përndjekja, i moderuar nga z. Simon Mirakaj, anëtar i AIDSSH, vijoi me prezantimet e historianëve Erald Kapri dhe Sonila Boçi, me temë “Martin Camaj në kontekstin e Luftës së Ftohtë” e “Faktet dhe opinionet në dosjet e Sigurimit të Shtetit, rasti i Camajt”.

Sipas Kaprit, “Jo pak dokumente të CIA-s, të studiura për Luftën e Ftohtë, duhen vënë në diskutim. Agjencia Amerikane ka nisur deklasifikimin e shumë prej dosjeve të saj, të cilat hidhen online për t’u përdorur në studime, me një saktësim të rëndësishëm metodologjik. Këto informacione janë të papërpunuara dhe kursesit studiuesit nuk duhet t’i marrin për të mirëqena, pasi janë përdorur në një kohë të caktuar gjatë Luftës së Ftohtë.”

Sipas Prof. As. Dr. Sonila Boçit të Institutit të Historisë, bashkëorganizatorë të tryezës dhe një ndër njohëset e dosjes së Martin Camajt, “Figurat historike duhet të trajtohen në kompleksitet. Duhet ndarë faktet nga opinionet në dosje dhe të arrihet në një reflektim të plotë, pas shqyrtimit të detajuar të tyre. Jo pas elementë të Sigurimit në dosje përbëjnë opinione, ashtu si faktet janë tregues i manovrave që përdorte makineria e shtypjes për të arritur qëllimet e përcaktuara në platformë.”



Ardita Repishti paraqiti një trajtesë të AIDSSH për “Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për studiuesit dhe mediat”, ku u përmend qasja e kujdesshme që duhet pasur në trajtimin e dosjeve të të shkuarës. “Për qëllime të kësaj tryeze, AIDSSH bëri kërkesë zyrtare pranë Autoritetit Gjerman për hapjen e dosjeve të Stasit, për vënie në dispozicion të të gjitha materialeve që zotëronte arkivi i tyre për shtetasin Martin Camaj dhe katedrën e Albanologjisë në Universitetin Ludvig Maximilian të Mynihut. Paralelisht, homologët tanë gjermanë na asistuan me ekspertizë sa i takon trajtimin të dosjeve të personaliteteve historike. Përgjigjja e tyre ishte negative, nuk zotëronin asnjë dokument për personin në fjalë.”



Në video e punuar për këtë tryezë u përgatit nga znj. Dagmar Hovestadt e BSTU Gjermani, bashkëorganizatorë të aktivitetit, me sfidat 30-vjeçare të gjermanëve në përballje me dosjet e figurave historike, me temë “Mbi personalitetet dhe dosjet e tyre në shërbimet sekrete, përvoja me dosjet e ish-Stasit në Gjermani”.

Sesioni i fundit iu kushtua veprës së gjithanshme të Martin Camajt. Z. Bujar Hudhri, botues i Camajt në Shqipëri solli përvojën e vet të botimit dhe marrëdhënien me institucionet.

Në lidhje të drejtpërdrejtë nga Miçigani, z. Lisandri dhe znj. Aristeia Kola trajtuan “Mendimin kritik të Arshi Pipës mbi veprën “Dranja” të Martin Camajt”, një prezantim interesant e shumëplanësh i diktaturës, të shkuarës e së ardhmes në një vepër me simbolikë të spikatur.

“Vetjet” komplekse të krijimtarisë së Camajt” u trajtuan me profesionalizëm nga kërkuesja shkencore znj. Adriana Duka, një ndër kërkueset e dosjes së tij pranë AIDSSH, në kuadër të hulumtimeve për veprën e shkrimtarit.

“Profecia sociolinguistike e Camajt” u prezantua nga Prof. Ledi Shamku, me të gjitha ngjyrimet për të cilat dukej se Camaj ishte i qartë që në krye të herës, që të tre koinetë gjuhësore, deri te ndikimi i gjuhës nga shoqëria dhe gjetja e mënyrave të reja të shprehjes.



Znj. Rita Gjeka, drejtuese e Teatrit “Migjeni” Shkodër, bashkëorganizator i aktivitetit, foli për “Camajn në skenë”. Në vitin 2015, Teatri “Migjeni” shfaqti premierë botërore dramën e Camajt “Kandili i argjandit”, vepër “poetike”, siç u shpreh Gjeka, për nga mënyra e të shkruarit, saktësia e fjalëve dhe përjetimet e mesazheve të saj universale.

“Sintaksa e Martin Camajt - pasuri e papërsëritshme e gjuhës shqipe” e përgatitur nga znj. Majlinda Bushaj do të jetë pjesë e botimit të dedikuar për 95-vjetorin e Martin Camajt.

Në mbyllje, për të pranishmit u shfaq drama e regjistruar nga teatri “Migjeni” Shkodër “Kandili i argjandit”, që trajton marrëdhënien e vështirë të atyre që u quajtën “klasa të përmbysura” me pushtetin dhe Sigurimin e Shtetit.

Në tryezën e zhvilluar në Pallatin Presidencial, u ftuan përfaqësues të institucioneve homologe me të cilat AIDSSH bashkëpunon që prej krijimit; institucione dhe organizata homologe, trupi diplomatik, përfaqësues të institucioneve publike, qendrore e lokale, shoqatave të të drejtave të njeriut dhe të përndjekurve politikë; përfaqësues të universiteteve dhe institucioneve kërkimore në vend; mbi 50 studiues që janë shprehur publikisht për Camajn dhe që kanë tërhequr dosjen e tij pranë AIDSSH; gazetarë dhe përfaqësues të medias, për të shkëmbyer këndvështrime mbi figurën e albanologut dhe për t’i trajtuar figurat e personalitetet historike në dimension të gjerë.



Përgjatë aktivitetit u paraqit një ekspozitë e zgjeruar dokumentare e AIDSSH me tipologji të ndryshme të dosjeve të Sigurimit të periudhës 1944-1955, historikë, raporte, platforma, evidenca operative të kohës dhe dosje të mbi njëzet intelektualëve të përndjekur nga Sigurimi në Shqipëri dhe jashtë vendit. Po ashtu, krijimtaria letrare e Martin Camajt, e botuar nga Onufri.



Thirrja për aktivitetin u bë më 21 korrik, në përvjetorin e 95-të të Martin Camajt, për abstrakte dhe punime që u dorëzuan deri më 10 gusht, nga të interesuarit brenda dhe jashtë vendit.

Aktiviteti synoi të përfshinte sa më shumë zëra në debatin publik për Camajn e më gjerë, për figurat historike dhe jetën e tyre gjatë diktaturës, përndjekjen apo përfshirjen, duke shfrytëzuar ekspertizën e institucioneve që janë përballur në tre dekada tashmë, me situata të përafërta, dhe ndihmuar diskutimin për dosjet e intelektualëve të përndjekur, me tipologjinë e dosjeve të Sigurimit të viteve 1944-1955.

Duke pasur disa zëra e pikëvështrime në takim, duke vënë në dispozicion dokumente dhe duke servitur ekspertizë të qasjes në dokumente të policive sekrete, e cila ngre pyetje për vërtetësinë e tyre (jo autenticitetin, por përmbajtjen gjatë kohës së krijimit), kur qëllimi ishte i përcaktuar në platformë Sigurimi, plan masash, vijë sjelljeje, etj, tryeza ftoi në një reflektim për trashëgiminë e së shkuarës komuniste dhe formimin e kujtesës historike për këtë të shkuar.

*Për shkak të situatës së krijuar nga përhapja e COVID-19, tryeza u zhvillua në respektim të protokolleve dhe rregullave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

NJOHJA NXIT STUDIMIN

Dokumente dhe materiale arkivore të AIDSSH janë vënë në dispozicion të qytetarëve, familjarëve të të dënuarve politikë, studiuesve dhe gazetarëve, sipas kërkesës. Hulumtimi në materiale arkivore ka prodhuar artikuj shkencorë, mediatikë, duke inkurajuar dialog me universitetet, akademikët, komunitetet vendore, të mbijetuarit e familjarët e tyre, mediat dhe publikun e gjerë.

Studimet e mëposhtme u realizuan në kuadër të projektit mbi Sigurimin dhe shkencën, bashkëpunim i AIDSSH me Ambasadën Zvicerane dhe janë publikuar në dy gjuhë.



“Armik i pushtetit popullor” që shkencërisht “punon për ne”: Shteti komunist dhe studiuesi Eqrem Çabej

Dr. Ledia Dushku

Profili i studiuesit Eqrem Çabej ka qëllim të paraqesë aspekte thelbësore të veprimtarisë së tij shkencore, të vendosura në kontekstin historik të kohës. Analiza ka si pikënisje formimin e hershëm njerëzor dhe intelektual të Çabejt, për të kuptuar në vijim sjelljen e regjimit komunist ndaj tij. Prezantimi në disa këndvështrime i personazhit, gërshetuar me paraqitjen e tipareve që fitoi “shkenca” dhe “punonjësi i mendjes” në Shqipërinë e viteve 1945-1954, janë në funksion të zbulimit të sjelljes së regjimit ndaj tipologjisë së intelektualit, të përfaqësuar nga E. Çabej; për të kuptuar se deri në çfarë mase qëndrimi i shtetit kushtëzohej nga marrëdhënia e intelektualit me Sigurimin e Shtetit, nga tiparet e profilit të tij psikologjik, veprimtarisë shkencore, qëndrimin të partisë-shtet dhe vetë Enver Hoxhës.

Arshi Pipa, profili i një studiuesi të padëshiruar

Dr. Andi Pinari dhe Indrit Qehajaj

Arshi Pipa, intelektual, nuk mund ta duronte sistemin e ri që po instalohej në Shqipëri. Arma që kishte në dorë për të kundërshtuar këtë sistem ishte ajo që zotëronte më së miri, poezia. Në librin e tij “Letërsia Bashkëkohore Shqiptare”, të botuar në anglisht në Nju Jork në vitin 1991, Arshiu shkruan për “përplasjet” me regjimin dhe shkaqet që e çuan në burg.

Gjergj Kokoshi dhe kontributi i tij politik në një atmosferë atipike politike në Shqipërinë e pasluftës

Dr. Enriketa Pandelejmoni

Në këtë punim trajtohet figura e Gjergj Kokoshit, në kuadër të kontributit të tij politik në vitin e parë të pas Luftës së Dytë Botërore, duke u bazuar në burime kryesisht arkivore, nga Arkivi Qendror i Shtetit si dhe nga Arkivi i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Synimi është shkrimi i një studimi, duke e bazuar analizën në burimet arkivore, por jo vetëm dhe duke patur në qendër analizën diskursive në hedhjen dritë mbi një nga figurat më interesante dhe më pak të zbardhura në vitin e parë të konsolidimit të pushtetit nga Partia Komuniste, siç është Gjergj Kokoshi. Emri i Gjergj Kokoshit, profesorit, filloi të dëgjohet mjaft pas Kongresit të Përmetit, kongres që vuri bazat e regjimit komunist në Shqipëri. Në këtë kongres, ai u zgjodh një prej anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar, struktura legislative e qeverisjes së shtetit shqiptar

Regjimi komunist dhe studiuesi: rasti i biologes Sabiha Kasimati

Dr. Ledia Dushku dhe Doris Pasha

Profili i biologes Sabiha Kasimati ka qëllim të paraqesë aspekte thelbësore të veprimtarisë së saj intelektuale dhe shkencore, të vendosura në kontekstin historik të kohës. Paraqitja në disa këndvështrime e personazhit ndihmon lexuesin të kuptojë deri në çfarë mase sjellja e regjimit ndaj intelektualit kushtëzohej nga veprimtaria shkencore, tiparet e profilit psikologjik, apo marrëdhënia me drejtuesit e lartë komunistë, në rastin e Sabiha Kasimatit me vetë Enver Hoxhën. urimet kryesore arkivore të shfrytëzuara në përpilimin e profilit të Sabiha Kasimatit janë: dokumentet e Arkivit Qendror të Republikës së Shqipërisë, pjesë e fondeve të Mministrisë së Partisë (Strukturat dhe Oorganet Uudhëheqëse), Kryeministrisë; dokumentet e Dosjes së Hetuesisë së të akuzuarve për bombë në legatën Sovjetike dhe ato të Dosjes Formulare të Eqrem Çabejt, konsultuar pranë AIDSSH.

Petraq Pepo: intelektual i dhe historiani përballë indoktrinimit komunist

Dr. Sonila Boçi dhe Kristi Kolçe

Studimi është ndarë në tri pjesë, të cilat pasqyrojnë tri periudha shumë të rëndësishme në historinë e Petraq Pepos: fëmijëria, familja dhe shkollimi; veprimtaria e tij gjatë Luftës së Dytë Botërore, e cila në një masë të madhe përcaktonte sjelljen e regjimit ndaj individëve; dhe, së fundi, veprimtaria e tij si pjesë e Institutit të Shkencës. Janë shfrytëzuar për këtë studim një numër i madh dokumentesh nga një sërë fondesh të Arkivit të Shtetit, nga Arkivi i Ministrisë së Jashtme, si dhe nga dosjet formulare të kolegëve të Petraq Pepos që gjenden pranë Autoritetit për Informimin mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit. Është përdorur edhe literatura historike relevante si për personazhin në studim, ashtu edhe shtypi i kohës. Intervista me familjarët e prof. Pepos, si dhe me kolegë të tij na kanë bërë të kuptojmë më shumë njeriun që qëndron prapa historianit.

**Vështrim antropologjik mbi persekutimin e shkencëtarëve përgjatë viteve 1945 – 1955.
Rasti i inxhinier Gjovalin Gjadrit: i vëzhguari i komunizmit**

Prof. Ass. Dr. Albert P. Nikolla dhe Joana Doda

Rasti i marrë në shqyrtim i nënshtrohet një metodologjie kërkimore shumëplanëshe, gjë që na e dikton vetë personaliteti i inxhinier Gj. Gjadrit. Ndikimi i përvojës studimore austriake, puna në BS dhe më vonë në Shqipëri, na shtyjnë të shohim me vëmendje dinamikat kulturore të sjelljes së inxh. Gjadrit ndaj çështjes së shpërblimit të punës, në këndvështrimin e antropologjisë ekonomike. Në pjesën kryesore të studimit, ndiqet metodologjia e antropologjisë historike, nëpërmjet së cilës analizohen dokumentet arkivore nën dritën e elementeve të pranishme kulturore që na japin mbështetjen e duhur për t'u thelluar në analizë. Interes të thellë antropologjik për studimin përbën ndeshja e shpeshtë në arkiva e termit “përdorim” për t’iu referuar personave. Sipas nesh, kjo është dëshmi e qartë e reduktimit të qenies njerëzore në mjet, në objekt, gjë që i hap rrugën edhe kulturalisht një persekutimi që rregullohet deri me ligj nga regjimi.

Përndjekja e shkencëtarëve shqiptarë në vitet 1945–1955. Lidhja ndërmjet shkencës dhe ideologjisë dhe rasti i përndjekjes së inxh. Petraq Qafokut

Prof. Ass. Dr. Albert P. Nikolla

Studimi vë në dukje se si trajtohet rasti i inxh. P. Qafokut nga gjykata komuniste dhe nga Sigurimi i Shtetit dhe se si, nëpërmjet dhunës, dijet e tij përdoren për të “mirën socialiste”! Përgjatë gjithë analizës studimore, rasti i inxh. Qafokut do të analizohet duke dëshmuar nëpërmjet historisë së tij, elementet e ngjashme ose të përbashkëta që pati regjimi komunist në dhunën që përdori ndaj intelektualëve dhe shkencëtarëve shqiptarë me modelin sovjetik që e pati si pikë referimi.

*Studimet mund të lexohen të plota në faqen e AIDSSH, www.dosjet.gov.al dhe në www.issuu/aidssh.



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHËTETIT

Adresa
Garda e Republikës, Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë
www.autoritetidosjeve.gov.al